





Për:	Menaxheret e regjioneve
Përmes:	Januz Krasniqi, Drejtor i ATK-se 
Nga:	Sakip Imeri, zv/drejtor – Përmbushja e detyrimeve 
Data:	28.05.2007
Lënda:	Udhëzim për aplikimin dhe pajisjen me Certifikata të TVSH-së

### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është që bizneseve të cilat janë të interesuara të pajisen me Certifikatë të TVSH-së tu ofrojë informata se në çfarë mënyre dhe çfarë dokumentacioni duhet të përgatisin dhe të dorëzojnë në Zyrat e ATK-së për tu pajisur me një certifikatë të tillë dhe njëkohësisht stafit të Zyrave Regjionale të Shërbimit të Tatimpaguesve t'iu përkujton përgjegjësitë që kanë lidhur me këtë çështje dhe hapat që duhet të ndërmarrin.

### Neni 2 Fushë veprimtaria e këtij udhëzimi

2.1. Paraprakisht, dëshirojmë që bizneset të dinë se në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/17 mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, cilat biznese janë të obliguara të aplikojnë për regjistrim në TVSH, cilat mund të regjistrohen si deklarues vullnetar dhe cilat biznese duhet të aplikojnë për tu pajisur me Certifikatë të TVSH-së:

2.2. Të gjitha bizneset të cilat importojnë, eksportojnë, bëjnë hyrje nga RFJ apo dalje drejt RFJ-së dhe kalojnë qarkullimin vjetor mbi 50.000 € janë të obliguara të aplikojnë për tu regjistruar si deklarues të TVSH-së. Në këtë rast vlen të theksohet se statusin e deklaruesit vullnetar (*me të drejta dhe obligime si të deklaruesve me qarkullim mbi 50.000 €*) mund ta marrin edhe bizneset që nuk e kanë arritur qarkullimin mbi 50.000 € .

2.3 Po ashtu, të gjitha bizneset që importojnë, eksportojnë, bëjnë hyrje nga RFJ apo dalje drejt RFJ-së duhet të aplikojnë për tu pajisur me certifikate regjistrimi për TVSH.

2.4. Sipas nenit 3, paragrafit 3.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2002/17 mbi TVSH-në, personi duhet të kërkojë të regjistrohet për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar brenda 15 ditësh nga data kur ai person bëhet person i tatueshëm.

2.5. Po ashtu sipas nenit 25 të Rregullores në fjalë personi i tatueshëm do ta njoftojë ATK-në me shkrim brenda 15 ditësh për çfarëdo ndryshimi në lidhje me emrin e personit, adresën, aktivitetet ekonomike ose informata tjera të cilat i janë dhënë ATK-së në kohën e regjistrimit.

### Neni 3

#### Aplikimi për Certificate të re te TVSh-së

3.1. Me rastin e aplikimit të tatimpaguesit për tu regjistruar për TVSH, Zyra e Shërbimit duhet pasur parasysh të dhënën që formulari i regjistrimit për TVSH-në, të jetë i plotësuar me të gjitha shënimet e kërkuara në formular, të jetë plotësuar me shkrim të qartë dhe pa gabime.

3.2. Po ashtu, Stafi i Zyrës së Shërbimit është i obliguar që në çdo kohë të jetë i gatshëm që biznesit të interesuar për regjistrim në TVSH t'i ofrojë informata të nevojshme lidhur me të drejtat dhe obligimet që do t'i ketë me rastin e marrjes së një statusi të tillë.

3.3. Nga Zyra përkatëse Regjionale kërkohet që të ruaj nga një kopje të secilës formë me rastin e regjistrimit apo modifikimit në TVSH.

Çfarë duhet të ketë të bashkëngjitur formulari i regjistrimit apo modifikimit me rastin e aplikimit për TVSH ?

- \* Dokumentin personal të identifikimit (kartelë identifikuese me nr. personal të UNMIK-ut ose pasaportë në rastin kur është fjala për persona jorezident (çdo person që nuk ka vendqëndrim të përhershëm në Kosovë, konsiderohet jorezident).

- \* Fotokopjen e certifikatës unike të regjistrimit të biznesit të lëshuar nga Zyra përgjegjëse për regjistrimin e bizneseve.

- \* Certifikatën/at origjinale TVSh-së (në rast se ka qenë edhe më parë i regjistruar në TVSH)

- \* Gjendjen e printuar në letër përmes së cilës arrihet të konstatohet se nuk ka obligime tatimore të pa përmbushura.

- \* Autorizimin me shkrim në rast se nuk është pronar i biznesit por që aplikon në emër të tij.

- \* Deklaratën me shkrim se është i gatshëm t'i marrë mbi vete të gjitha përgjegjësitë që lidhen me certifikatën e vjetër të TVSH-së

- \* Përshkrimin e dëshmime të bashkëngjitura me rastin e aplikimit për certifikatë të TVSH-së.

- \* Kopjen e dëshmisë për pagesën e dënimit në rast se aplikon për tu regjistruar pas afatit të paraparë me dispozitat ligjore.

#### Neni 4

Çfarë duhet tjetër të ketë parasysht Stafi i Zyrës së Shërbimit të Tatimpaguesve me rastin e pranimit të këtyre formave ?

4.1. Nëse me rastin e verifikimit në Bazën e SIGTAS-it vërehet se ndonjë nga deklaratimet e tatimeve apo kontributeve (pavarësisht se për cilin tatim apo kontribut është fjala) nuk është e përfshirë në gjendjen e printuar, ndërkaq pala ofron deklaratën origjinale si dëshmi se ka paguar tatimet/kontributet pensionale, atëherë inspektori i Zyrës së Shërbimit autorizohet që këtë deklaratë origjinale të paraqitur nga tatimpaguesi, ta fotokopjojë, atë kopje ta vulos me vulën e Tij/saj, nënshkruaj dhe t'ia bashkëngjes aplikacionit.

4.2. Gjithashtu, nga ana e personit/ave përgjegjës të Zyrës së Shërbimit duhet të bëhet krahasimi i formularëve të pagesave origjinale dhe fotokopjeve të cilat dorëzohen nga ana e tatimpaguesit me rastin e aplikimit dhe të vërtetohet saktësia e tyre.

4.3. Nëse pala nuk ka dëshmi se i ka kryer obligimet tatimore, atëherë duhet që palës t'i sugjerohet që së pari duhet t'i kryej obligimet tatimore dhe t'i sjell dëshmitë lidhur me shlyerjen e borxhit me qëllim që ato t'i bashkëngjiten aplikacionit, dhe tek pastaj aplikacioni të pranohet nga Zyra e Shërbimit të Tatimpaguesve.

4.4. Në këto raste tatimpaguesit për shkak të pagesës së tatimit me vonesë mund t'i lindin obligime të tjera si pasojë e kësaj vonese mirëpo me qëllim të shpejtimit të procedurës dhe njëkohësisht për t'i dalë në ndihmë tatimpaguesit si dhe duke pasur parasysht se ato dënime me të cilat sanksionohet do t'i paguajë në të ardhmen certifikata do t'i printohet (lëshohet).

#### Neni 5

##### Detyrimet e tatimpaguesve

5.1. Duhet të potencohet edhe detyrimi i tatimpaguesve që me rastin e aplikimit për tu pajisur me Certifikatë të TVSH-së të plotësojnë Formularin AU 005.

5.2. Këtu duhet të shtojmë edhe këtë të dhënë se, bartja e mjeteve nga një periudhë në tjetrën duhet të bëhet nga inspektori përgjegjës tatimor mirëpo këtë veprim tatimpaguesi duhet ta kryejë para se të aplikojë për tu pajisur me Certifikatë të TVSH-së.

5.3. Vërejtje: \* Derisa aplikacioni të mos jetë plotësisht i kompletuar me dokumentet që kërkohen, Certifikata e TVSH-së nuk do të printohet, vuloset e as të nënshkruhet nga inspektorët e Zyrës përkatëse të Shërbimit të Tatimpaguesve.

Po ashtu nëse tatimpaguesi bën gabim gjatë plotësimit të aplikacionit, nuk lejohet që gabimi të korrigjohet me korrektor, por duhet të plotësohet aplikacioni i ri.

Me rastin e kompletimit të aplikacionit nga inspektori i shërbimit lënda duhet të verifikohet nga udhëheqësi i ekipit të zyrës së shërbimit të tatimpaguesve, i cili e dërgon te menaxheri për nënshkrim duke i bashkëngjitur formën e konfirmimit.



UNMIK

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE/TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO  
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA/ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS  
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE/PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA



## KONFIRMIM

**Data:** \_\_\_\_\_

**Për:** Menaxheri Regjional

**Nga:** Udhëheqësi i ekipit me nr. Të ID-së \_\_\_\_\_

**Lënda:** Konfirmim

Kërkesat e Tatimpaguesve të përgatitura konform Udhëzimit Administrativ, për lëshimin e certifikatave të TVSH-së.

1.	_____	TIN: _____
2.	_____	TIN: _____
3.	_____	TIN: _____
4.	_____	TIN: _____
5.	_____	TIN: _____
6.	_____	TIN: _____
7.	_____	TIN: _____
8.	_____	TIN: _____
9.	_____	TIN: _____
10.	_____	TIN: _____

Është kontrolluar edhe nga ana ime dhe unë e konfirmoj se është në rregull dhe mund të nënshkruhet edhe nga ana juaj.

Inspektori Tatimor

Udhëheqësi i ekipit

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

## **Neni 6**

### **Dhënia e Certifikatës së TVSH-së**

6.1. Kur tatimpaguesi dorëzon aplikacionin e kompletuar siç kërkohet nga ai në Zyrën përkatëse Regjionale atëherë pasi të jenë kryer procedurat e parapara më lartë nga ana e stafit të Zyrës së Shërbimit, shtypet, e pastaj nënshkruhet dhe vulozet nga Menaxheri i Zyrës përkatëse Regjionale të Shërbimit të Tatimpaguesve.

6.2. Vlen të theksohet se tatimpaguesit mund t'i lëshohen po aq Certifikata sa është edhe numri i vendeve të deklaruara të biznesit mirëpo secila certifikatë do ta ketë numrin identifikues të njëjtë.

6.3. Përveç datës se printimit tek deklaruesit e TVSH-se në certifikatë duhet të shënohet edhe data kur e ka arritur qarkullimin 50.000 € kurse kur është fjala për deklaruesit vullnetarë data nga e cila ata dëshirojnë të regjistrohen si deklarues të TVSH-së.

6.3. Para se t'i jepet tatimpaguesit certifikata e vulosur e TVSH-së ajo duhet të fotokopjohet dhe të ruhet (arkivohet) në Zyrën përkatëse të Shërbimit të Tatimpaguesve.

6.4. Me rastin e tërheqjes së certifikatës nga ana e palës ajo duhet të nënshkruhet nga ana e tij, duhet të shënohet emri dhe mbiemri i plotë i tij si dhe duhet kërkuar numrin e dokumentit të identifikimit për verifikim, dhe të shënohen të dhënat e nevojshme.

## **Neni 7**

### **Cilët janë hapat tjerë që Zyrat Regjionale të ShET duhet të ndërmarrin?**

7.1. Certifikatën e printuar, nëse brenda afatit prej 10 ditësh ( prej ditës kur certifikata është dorëzuar në Zyrën Regjionale), tatimpaguesi nuk e tërheq atë, atëherë duhet personat përgjegjës të ATK-së ta gjejnë mënyrën për t'ia dorëzuar certifikatën e TVSH-së tatimpaguesit përkatës ( mirëpo me këtë rast duhet pasur shume kujdes në mbajtjen e shënimeve se kush e ka marr atë obligim për ta dorëzuar certifikatën e TVSH-së).

7.2 Në rastin e kundërt nëse lëndët e pa kompletuara brenda afatit prej 10 ditësh nuk kompletohen nga ana e tatimpaguesve, po ashtu ato do t'i kthehen atyre dhe aplikimi i sërishëm duhet te regjistrohet sipas procedurës së rregullt ( sikur tatimpaguesi të kishte aplikuar për herë të parë).

## **Neni 8**

### **Ndërrimi i Certifikatës**

Në rastin kur kemi të bëjmë me ndërrim të certifikatës së TVSH-së (për shkak të ndërrimit të statusit, ndërrimit të emrit, apo për ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm), pronari i biznesit apo personi i autorizuar me shkrim, duhet të aplikojë në Zyrën përkatëse Regjionale të Administratës Tatimore të Kosovës dhe ta plotësojë formularin për modifikim (ndryshim) dhe këtij formulari t'ia bashkangjes të gjitha dokumentet që kërkohen sikur me rastin e regjistrimit për herë të parë, në këto raste duhet të dorëzohet certifikata e vjetër e TVSH-së.

## **Neni 9** Humbja e Certifikatës

Në rastet kur një biznes e humb certifikatën e TVSH-së, Ai duhet të aplikojë sërish në Zyrën përkatëse të ATK-së për certifikatë dhe përveç dokumenteve që kërkohen me rastin e regjistrimit, duhet t'i bashkëngjitet edhe:

- Një deklaratë me shkrim të nënshkruar nga ana e palës përmes së cilës pala i merr përsipër të gjitha përgjegjësitë që lidhen me certifikatën e tij të humbur,
- Gjithashtu tatimpaguesi duhet ta shpallë të pavlefshme certifikatën e humbur në media përkatëse, dhe këtë dokument ta bashkëngjies në aplikacionin e tatimpaguesit.

## **Neni 10** Mbyllja e biznesit

10.1. Në rastin kur një tatimpagues vendos ta mbyll biznesin e tij, atëherë ai është obliguar që :

- Ta kthejë certifikatën e TVSH-së në Zyrën përkatëse Regjionale;
- Ta plotësojë një formular të modifikimit.
- Ta posedojë formën e vërtetuar të çregjistrimit të biznesit, lëshuar nga Zyra përgjegjëse për Regjistrimit e Bizneseve.

10.2. Pastaj, lënda shkon në Departamentin e Teknologjisë Informative, ku Departamenti në fjalë duhet të printojë një formë me të cilën tregohet se biznesi i caktuar është mbyllur. Një kopje e formës së tillë duhet t'i bashkëngjitet aplikacionit dhe të dorëzohet në arkiv për ruajtje, ndërsa dy kopje tjera duhet të përcillen në regjionin përkatës ku Zyra e Shërbimit një kopje duhet të vendos në dosjen e tatimpaguesit përkatës kurse kopjen tjetër duhet t'ia dorëzojë palës e cila e ka mbyllur biznesin. Po ashtu për një hap të tillë duhet të njoftohet edhe Shërbimi Doganor.

## **Neni 11** Korrigjimi i gabimeve

11.1. Sa i përket rastit kur biznesi gabimisht është përfshirë në TVSH si deklarues vullnetar, ai ka të drejtë ta bëjë korrigjimin (ndryshimin) e nevojshëm por me kusht që: **kërkesa për ndryshim** është bërë pa kaluar afati i deklarimit për periudhën kur është përfshirë në TVSH dhe TVSH-në e mbledhur (nëse është mbledhur) duhet paraprakisht ta paguajë.

11.2. Për bizneset të cilat dëshirojnë të eksportojnë, atyre do tu lëshohet certifikata e TVSH-së me mbishkrim "VETËM PËR EXPORT". Një certifikatë e tillë ka ngjyrë të bardhë dhe për këtë lloj certifikate tatimpaguesit duhet të drejtohen në Zyrën e Edukimit të Tatimpaguesve.

Me që rast, kërkohet :

- Plotësimi i formularit të regjistrimit,
- Fotokopja e dokumentit të identifikimit
- Fotokopja e certifikatës së regjistrimit
- Një kërkesë me shkrim lidhur me arsyeshmërinë e lëshimit të certifikatës

11.3. Për këtë lloj certifikate zyra e Edukimit të Tatimpaguesve duhet të mbajë shënime të veçanta.

## **Neni 12**

Paisja më Certifikate edhe kur tatimpaguesit kane obligimeve tatimore

12.1. Një biznes mund të pajiset me certifikatë të TVSH-së edhe përkundër obligimeve tatimore që ka ndaj ATK-së, nëse radhitet në njërin nga kategoritë e mëposhtme:

12.2. Nëse, Obligimi tatimor i papaguar i tatimpaguesit është më pak se **1/3** e borxhit të përgjithshëm (dmth. **2/3** duhet të paguhet pavarësisht nga qarkullimi i tatimpaguesit).

Këtë do t'a ilustrojmë me një shembull të thjeshtë:

Borxhi i përgjithshëm .....	900 euro
<u>Pagesa e 2/3 të borxhit.....</u>	<u>600 euro</u>
Borxhi i mbetur për pagesë.....	300 euro

12.3. Nëse, tatimpaguesi si rezultat i kontrollit ka tatim shtesë, atëherë brenda 10 ditësh nga dita e lëshimit të njoftim vlerësimit ( **AU 011**) mund t'i lejohet marrja e certifikatës së TVSH-së.

12.4. Nëse është arritur marrëveshje për mënyrën e shlyerjes së borxhit, me kusht që tatimpaguesi ta ketë të paguar një të tretën (**1/3**) e borxhit total që e ka ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (Dëshmia me shkrim se është lidhur marrëveshja dhe është bërë pagesa e një të tretës së borxhit duhet t'i bashkëngjitet lëndës me rastin e aplikimit për certifikatë)

Borxhi i përgjithshëm .....	900 euro
<u>Pagesa e 1/3 të borxhit.....</u>	<u>300 euro</u>
Borxhi i mbetur për pagesë.....	600 euro

12.5. Të gjitha subjektet tatimore që bëjnë pjesë në shërbime publike dhe vetëm në rastet kur janë obligues ndaj tatimit të paragjykuar.

**Neni 13.**  
Ndëshkimet

13.1. Nëse tatimpaguesi nuk vepron konform nenit 3.2 dhe 25 të Rregullores së TVSH-së atëherë bazuar në nenin 27 të Udhëzimit Administrativ të TVSH-së do të ndëshkohet me gjobë prej 125 € për shkak të dështimit të njoftimit të ndryshimeve.

13.2. Gjithashtu, sipas nenit 49, paragrafi 49.1 të Ligjit Nr. 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat secili tatimpagues i cili ka detyrë të regjistrohet për TVSh dhe i cili kryen furnizime pa qenë i regjistruar për TVSh do të jetë përgjegjës për detyrimin e TVSh-së mbi ato furnizime plus sanksioni prej:

- a. njëzetepesë përqind (**25%**) të detyrimit tatimor mbi ato furnizime nëse mos regjistrimi ka ndodhur për shkak të pakujdesisë ose pakujdesisë së madhe të personit të tatueshëm; apo
- b. një qind përqind (**100%**) të detyrimit tatimor në ato furnizime nëse mos regjistrimi ka ndodhur për shkak të synimit me paramendim ose me qëllim të personit të tatueshëm që mos të paguajë TVSh-në për ato furnizime.

13.3. Bazuar në nenin 49, paragrafin 49.4 të Ligjit Nr. 2004/48 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat ; *çdo tatimpagues i regjistruar për TVSh i cili i lejon një personi tjetër të përdorë certifikatën e tij unike të TVSh-së do t'i nënshtrohet një sanksioni prej 5.000 €.*

**Neni 14.**  
Dispozitat kalimtare

Ky udhëzim i shfuqizon te gjitha udhëzimet e mëparshme që kanë rregulluar këtë lëmi.

**Neni 15**  
Hyrja ne fuqi

Udhëzimi administrativ hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të tij.